



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr. 417/2 prot

Datë 22.02.2024

**FORMULAR PËR PUBLIKIM**  
**LIDHUR ME ARSYET E SKUALIFIKIMIT NË RASTIN E ANKESAVE PËR**  
**VENDIMIN E VLERËSIMIT/KLASIFIKIMIT PËRFUNDIMTAR**

**Objekt:**

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “4IG PLC” në procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-91482-12-18-2023, me objekt: “Vleresim i pergjithshem mbi Sigurine Kibernetike dhe kryerjen e testimeve mbi Infrastrukturen dhe Platformat Teknologjike”, me fond limit 106,833,333 (Njeqind e gjashte milion e teteqind e tridhete e tre mije e treqind e tridhete e tre) leke pa TVSH ose 11,033,504 (Nje milion e tridhete e tre mije e peseqind e kater) euro pa TVSH. Referuar kursit te kembimit te B.SH date 18.12.2023 ku 1 euro = 103.37 All), zhvilluar me datë 24-01-2024 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Shperndarjes se Energjise Elektrike Group sh.a.

**Ankimues:**

Operatori ekonomik “4IG PLC”, me NIPT HU12011069, me adresë: Krisztina korut 39, Budapest, Hungari, Kodi postar 1013

**Autoriteti Kontraktor:**

Operatori i Shperndarjes se Energjise Elektrike Group sh.a., me adresë: Blv “Gj. Fishta”, Nd.Nr. 88, H.1, Njësia Administrative Nr.7, 1023, Tiranë

Në datën 21.02.2024 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa protokolluar me nr. 417/2024 prot., e operatorit ekonomik “4IG PLC” për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-91482-12-18-2023, me objekt: “Vleresim i pergjithshem mbi Sigurine Kibernetike dhe kryerjen e testimeve mbi Infrastrukturen

dhe Platformat Teknologjike”, me fond limit 106,833,333 (Njeqind e gjashte milion e teteqind e tridhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e tre) leke pa TVSH ose 11,033,504 (Nje milion e tridhjetë e tre mijë e peseqind e kater) euro pa TVSH. Referuar kursit të kembimit të B.SH date 18.12.2023 ku 1 euro = 103.37 All), zhvilluar me datë 24-01-2024 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Shperndarjes se Energjise Elektrike Group sh.a.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “4IG PLC”, në procedurën e mësipërme të prokurimit.

Bazuar në nenin 112, pika 4, gërma “b” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: “Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon:

*b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar;”.*

Komisioni i Prokurimit Publik do të publikojë arsyet e skualifikimit që operatori ekonomik “4IG PLC” kundërshton me anë të ankesës me nr. 417/2024 prot., datë 29.12.2023. Konkretisht:

*nuk ploteson shkronjen b te pikes 2.3.2 ISO 27001:2022 Nuk ploteson piken 2.3.3 te kapacitetit teknik pasi nuk ka specialist te certifikuar CISO.*

Publikuar në regjistrin e ankesave më datë 22.02.2024.

## **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Nënkryetar**  
**Fiorent Zguro**

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Anëtar**  
**Anila Malaj**

**Kryetar**  
**Jonaid Myzyri**